



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KOLONJË
KËSHILLI BASHKIAK

Komisioni i ekonomise, financave, buxhetit dhe tatim taksave

Raport vendimmarrjeje

Nr 8 /Datë 27.01 2026

Lënda: Mendim/vendim i Komisionit për projektvendimin

“PËR MIRATIMIN E LIDHJES SË KONTRATËS SË SHËRBIMIT ME POSTËN SHQIPTARE Sh.A., FILIALI KORÇË, PËR ARKËTIMIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE”

Analiza ligjore:

Bazuar në Ligjin Nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 54, gërma e), Ligjin Nr. 68/2017 “Për Financat Vendore”, Ligji nr. 46/2015 “Për shërbimet Postare në Republikën e Shqipërisë”, Ligji nr.9001 datë 14.04.2008 “Për tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare”, i ndryshuar, Ligji nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

Situata aktuale e funksionit:

Propozohet miratimi për

1. Miratimin e lidhjes së Kontratës së Shërbimit ndërmjet Bashkisë Kolonjë dhe Postës Shqiptare Sh.A., Filiali Korçë, për arkëtimin e taksave, tarifave dhe detyrimeve të tjera vendore.
2. Shërbimi i arkëtitimit përfshin pranimin e pagesave nga taksapaguesit, lëshimin e dokumentacionit përkatës financiar dhe transferimin e shumave të arkëtuara në llogaritë bankare të Bashkisë Kolonjë.
3. Afati i kontratës do të jetë 1 (një) vit, me të drejtë rinovimi sipas legjislacionit në fuqi.

Situata financiare:

Sipas relacionit dhe dokumentacionit qe shoqeron projekt vendimin

Drejtoria/Spektori përgjegjës:

Administrata e bashkise Kolonje

Drejtoria e finances

Monitorimi dhe raportimi:

Keshilli I Bashkise Kolonje

Impakti social/grupet qe preken:

Qytetare te bashkise Kolonje

A është objekt i konsultimit publik?

Jo

Komisioni i ekonomise, financave, buxhetit dhe tatim taksave i mbledhur më datë 27.01 2026, shqyrtoi projektvendimin "PËR MIRATIMIN E LIDHJES SË KONTRATËS SË SHËRBIMIT ME POSTËN SHQIPTARE Sh.A., FILIALI KORÇË, PËR ARKËTIMIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE" Pas shqyrtimit të projektvendimit dhe materialeve shoqëruese, komisioni me shumicë votash, vendosi:

T'i propozojë Keshillit bashkiak:

- a (Miratimin e projektaktit.
- b- Kalimin e projektaktit në mbledhjen e Këshillit për vlerësimin e mëtejshëm dhe për shqyrtim.
- c- Refuzimin e miratimit të projektaktit.
- d- Miratimin e projektaktit me ndryshimet si më poshtë:)

Bashkëlidhur argumentet e vendimmarrjes dhe mendimi i pakicës i paraqitur në procesverbalin e mbledhjes së komisionit.

_____ **Kryetar i komisionit**

(emri, mbiemri, firma)

Soelto Larti



_____ **Sekretar i komisionit**

(emri, mbiemri, firma)

Datë: 27.01. 2026